



Shkodër, me 12.12.2019

Thirrje për sallë konference dhe shërbim bar-katering

Pozicioni: Subjekt tregtar qiradhënës & shërbime të tjera

Titulli i projektit: “Youth WAVE for Human Rights”

Shtyrja e afatit të aplikimit: 15 Dhjetor 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Youth Wave for Human Rights” zbatohet në Shkodër në kuadër të Projektit “Të rinjtë në Shqipëri për të Drejtat e Njeriut” i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga World Vision në bashkëpunim me Rrjetin e të Rinjve Jugoro-Lindor. Ky projekt ka për qëllim aftësimin dhe fuqizimin e të rinjve për të ndërtuar komunitete miqësore dhe respektuese ndaj të drejtave të njeriut dhe përfshin zhvillimin e një sërë aktivitetesh që i shërbejnë arritjes së këtij qëllimi.

2. Qëllimi i kontratës

Përcaktimi i termave të angazhimit të subjektit tregtar për realizimin e konferencës.

3. Produkti i punës

Kjo konferencë planifikon të prezantojë “*Akademia Rinore për të Drejtat e Njeriut*” që konsiston në prezantimin e rolit dhe aktivitetet e akademisë dhe si do të bashkëpunojë kjo akademi me institucione të ndryshme për ta mbështetur atë në avancimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Konferenca do të përmbajë seanca të ndryshme si folës në panel ku ekspertët do të flasin për aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut në Shqipëri, kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, problematikat e identifikuar, etj. Konferenca do të përmbajë gjithashtu seminare pune paralele, me tema të ndryshme.

4. Vendi i zhvillimit të aktivitetit

Aktiviteti do të zhvillohet në hapësirën territoriale të Bashkisë Shkodër.

5. Roli dhe përgjegjësitë e subjektit

Aktiviteti do të fillojë pas nënshkrimit të kontratës dhe konsiston në:

- Vënien në dispozicion të tre sallave pune (1 sallë konference me kapacitet 80 persona dhe 2 salla seminari me kapacitet 25 persona secila);
- Përgatitjen dhe realizimin e shërbimit kafeteri dhe konfeteri për dy pushime kafeje, për 80 persona;
- Përgatitjen dhe realizimin e shërbimit katering për 80 persona;
- “Gruaja tek Gruaja” dhe stafi i angazhuar në projekt kanë fjalën e fundit lidhur me produktin final.

6. Kohëzgjatja e kontratës dhe planifikimi i punës

- Aktiviteti do të realizohet brenda një dite;



- Afati për planifikimin dhe realizimin e shërbimeve do të vendoset paraprakisht, pas firmosjes së kontratës, me marrëveshje mes ofruesit të shërbimit dhe koordinatorit të projektit;
- Produkti final duhet të jetë i përfunduar deri me datën 31 Dhjetor 2019 që është edhe data e përfundimit të projektit.

7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

- Ofrimi i të gjitha materialeve teknike për sallat në dispozicion;
- Aftësi për të realizuar shërbimet e kërkuara brenda limiteve kohore të përcaktuara dhe me standarte të larta profesionalizmi;
- Dërgim e-mail i të gjithë dokumentacionit të kërkuar;
- Ofrimi i të gjitha produkteve të kërkuara brenda të njejtës godine.

Subjekti fitues do të përzgjidhet në bazë të ofertës më të mirë financiare dhe teknike.

8. Dokumentacioni i nevojshëm

- Ofertë për shërbimet që do të realizohen;
- Ekstrakt QKR.

9. Pagesa

Mënyra e pagesës do të kryhet varësisht nga vullneti i të kontraktuarit në përfundim të të gjitha detyrimeve të listuara apo me dy transfertat duke përcaktuar një parapagesë për çeshtje sigurie.

Procedura e prokurimit ka një fond limit prej 1 500 Euro (njëmijë e pesëqind). Çmimet duhet të përfshijnë vlerën e TVSH-së. Subjekti i interesuar për t'iu përgjigjur ftesës për ofertë duhet të paraqesë ofertën e tij duke përdorur tabelën si më poshtë.

Nr.	Përshkrimi i produktit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Sallë konference (80 persona) 8 orë	Copë	1		
2	Sallë konference (25 persona) 2 orë	Copë	2		
3	Pushim kafe	Person	80		
4	Dreke konference	Person	80		
	Totali				

10. Aplikimi

Aplikimi/oferta duhet të dërgohet brënda datës 15.12.2019 me email në adresën: info@grujatekgrujaja.org.